

STATUTI I
SHOQERISE TREGTARE
“ZYFI FARM” SH.P.K.

Kreu 1

Dizpozita te pergjithshme

Neni 1

Sipas kerkesave te ligjit numer 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe atij numër 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, krijohet shoqëria tregtare “ZYFI FARM” Sh.p.k, e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe nenet e këtij statuti.

Neni 2

Në këtë statut termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

Statuti: Statuti i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar “ZYFI FARM” Shpk.

Shoqëria: Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ZYFI FARM” Shpk.

Ligji Tregtar: Ligji 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Në kuptim të këtij statuti, shprehjet në njëjës përfshijnë ato në shumës dhe anasjelltas me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës rezulton ndryshe. Përemri vetor “ai” përfshin edhe përemrin vetor “ajo” dhe përemrin vetor “atë”, nënkuptohen të dyja gjinitë me përjashtim te rasteve kur sipas kontekstit të dispozitës rezulton ndryshe.

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që shoqëria i drejton ortakëve sipas këtij statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen se janë kryer në mënyrë të rregullt kur dërgohen ortakëve në adresat e deklaruara prej tyre pranë administratorit të shoqërisë.

Kreu 2

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 3

Sot, me 25.12.2024, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin ZYFI FARM Sh.p.k.

Themeluesit e shoqërise “ZYFI FARM” Shpk janë:

- **ZYFI GROUP sh.p.k**, person juridik, themeluar dhe organizuar ne formen e nje shoqerie me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjislacionit shqiptar, regjistruar ne qendren kombetare te biznesit me 24.12.2024, me seli ne Rruga Kongresi i Lushnjes, Pallati nr.20, Kati V, Apartamenti 23, Tirane, perfaqesuar nga administratori z. Marild Zyfi, i datelindjes 29.03.1992, lindur ne Maliq, dhe banues ne Tirane, i pajisur me pasaporte nr pasaporte BG2572801 dhe nr. personal **J20329090V**.
- Z. Gerald Zyfi, i datelindjes 09.05.1988, lindur ne Maliq dhe banues ne Tirane, identifikuar me pasaporte me nr. Pasaporte BD1228746 dhe me nr Personal **I80509101V**.



- Znj. Jetlira Beqiraj, shtetase zviceriane, e datelindjes 27.07.1995, lindur ne Zvicer, dhe banuese ne Schaffhausen, Zvicer, identifikuar me pasaporte zviceriane me nr. **X0D32K05**.
- Znj. Arjona Zyfi, e datelindjes 03.08.1988, lindur ne Korce dhe banuese ne Tirane, identifikuar me karte identiteti me nr. leternjoftimi 036905840 dhe me nr Personal **I85803112C**.

Neni 4

Shoqeria do te kete statutin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- Prodhim, grumbullim, perpunim, ripaketim dhe tregtim te artikujve blegtoral e bujqesor. Tregtim me shumice dhe pakice, import - eksport te artikujve te ndryshem ushqimor dhe industrial.

Neni 6

Shoqeria e ka seline e saj ne:

Domje, Rruga e Dorbes, ndertesa nr. 14, objekt privat ne proces legalizimi me nr. Protokolli 3304, Tiranë.

Ajo mund te cele dhe adresa aktiviteti te tjera te dyta, dege e filiale ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashte saj.

Neni 7

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj pa afat.

Neni 8

Shoqeria ka vulen e saj.

Kreu 3 **Kapitali**

Neni 9

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 10.000.000 (Dhjetë milion) leke dhe perbehet nga 4 kuota. Pjesemarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

- **ZYFI GROUP sh.p.k**, person juridik, themeluar dhe organizuar ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar sipas ligjislacionit shqiptar, regjistruar ne qendren kombetare te biznesit me 24.12.2024, me seli ne Rruga Kongresi i Lushnjes, Pallati nr.20, Kati V, Apartamenti 23, Tirane, perfaqesuar nga administratori z. Marild Zyfi, i datelindjes 29.03.1992, lindur ne Maliq, dhe banues ne Tirane, i pajisur me pasaporte nr pasaporte BG2572801 dhe nr. personal **J20329090V**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme nominale 3.500.000 leke qe perben 35% te kapitalit themeltar te shoqerise.
- Z. Gerald Zyfi, i datelindjes 09.05.1988, lindur ne Maliq dhe banues ne Tirane, identifikuar me pasaporte me nr. Pasaporte BD1228746 dhe me nr Personal **I80509101V**, zoteruese e 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme nominale 3.500.000 leke qe perben 35% te kapitalit themeltar te shoqerise.

- Znj. Jetlira Beqiraj, shtetase zviceriane, e datelindjes 27.07.1995, lindur ne Zvicer, dhe banuese ne Schaffhausen, Zvicer, identifikuar me pasaporte zviceriane me nr. **X0D32K05**, zoteruese e 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme nominale 1.500.000 leke qe perben 15% te kapitalit themeltar te shoqerise.
- Znj. Arjona Zyfi, e datelindjes 03.08.1988, lindur ne Korce dhe banuese ne Tirane, identifikuar me karte identiteti me nr. leternjoftimi 036905840 dhe me nr Personal **I85803112C**, zoteruese e 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme nominale 1.500.000 leke qe perben 15% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Te gjitha kuotat e kapitalit themeltar do te shlyhen me afat deri ne 3 vjet. Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre.

Neni 10

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet ose te zvogelohet sipas vendimit te ortakeve.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendime ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 11

Ortaku mund te transferoje te treteve kuotat e tij te kapitalit pjeserisht ose teresisht. Transferimi i kuotave tek te tretet do te behet vetem pasi te kete marre vendim asambleja e ortakeve me shumice absolute te votave.

Kuotat e kapitalit mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise.
- b) Shitblerjes.
- c) Trashegimise.
- d) Dhurimit.
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Kreu 4

Organet vendimmarrese dhe drejtuese

Neni 12

Organet te shoqerise do te jene:

- Asambleja e ortakeve.
- Administratori.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit te organeve drejtuese rregullohet si me poshte.

Asambleja e ortakeve

Neni 13

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor.

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve merr vendime sa here e sheh te arsyeshme, por domosdoshmerisht per te miratuar pasqyrat financiare vjetore te shoqerise.

Neni 14

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) Emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore, shpërndarjen e fitimeve dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 15

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike te ortakeve. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.


Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas paragrafit te mesiperme te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht kesaj parregullsie.

Neni 16

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ajo mund te marre vendime te vlefshme, vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te përmendur më lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.



Neni 17

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat ($\frac{3}{4}$) e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per:

- a) Ndryshimin e statutit.
- b) Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar.
- c) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore.
- ç) Shperndarjen e fitimeve.
- d) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumice te votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - c) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) Përcaktimin e shpërblimeve
 - d) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - dh) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - e) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet ne QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Administrimi

Neni 18


Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona si administrator te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet, me te drejte riprteritjeje. Emerimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Neni 19

Administratori ka te drejte te perfaqesoj shoqerine ne marredhenie me te tretet per permbushjen e aktivitetit te saj ne perputhje me nenin 5 te ketij statuti.

Organi Administrativ (administratori) ka te drejte dhe duhet te:

- a) Kryeje me mirebesim të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakeve e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi;
- b) Përfaqësoje shoqërinë tregtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) Përgatit dhe nënshkruaj pasqyrat financiare vjetore, dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) Kryej regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;



ë) Kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
f) Marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta.
g) Përfaqësojë apo emërojë përfaqësues në çështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria ose në çështje të tjera me palë të treta;
Nese asambleja e pergjithshme emerone me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine, pervec rasteve kur ne vendimin e emerimit shprehet ndryshe.
Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

Neni 20

Administrator i shoqerise "ZYFI FARM" shpk emerohet:

1. Z. Gerald Zyfi, i datelindjes 09.05.1988, lindur ne Maliq dhe banues ne Tirane, identifikuar me pasaporte me nr. Pasaporte BD1228746 dhe me nr Personal **I80509101V**. Afati i mandatit te administratorit do te jete 5 vjet nga data e miratimit te ketij statuti.

Kreu 5

Kushtet ekonomike

Neni 21

Shoqeria eshte pronare, disponuese dhe perdoruese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjetër juridik ne Shqiperi, mund te bleje, te shese, te jape ne perdorim, etj.

Neni 22

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore hartohen pasqyrat financiare sipas ligjeve ne fuqi. Pasqyrat financiare periodike mujore, tremujore, gjashtemujore miratohen e nenshkruhen nga administratori i shoqerise. Pasqyrat financiare vjetore nenshkruhen nga administratori dhe miratohen nga Asambleja e pergjithshme e Ortakeve.

Neni 23

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit ne QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 24

Marredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut do zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne Republiken e Shqiperise. Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykaten shqiptare.

Kreu 6


Dizpozita te vecanta

Prishja – Riorganizimi i Shoqerise

Neni 25

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe, per shkaqet:

- a) Me vendim te Asamblese se Ortakeve per prishjen e shoqerise;



- b) Sipas rasteve te parashikuara nga Ligji Tregtar;
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) Me vendim te gjykates;

Neni 26

Ne rastin e prishjes se shoqerise, Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje ose disa likuidatore. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj punonjesve, shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprices se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet Ortakeve.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 27

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Asamblese se pergjithshme te Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare".

Baza ligjore

Neni 28

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter ne Republiken e Shqiperise.

Neni 29

Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteteve, zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert palet i drejtohen Gjykates se Republikes se Shqiperise per zgjidhje.

Neni 30

Ky statut u perpilua ne prani te ortakeve te shoqerise duke shprehur vullnetin e tyre te plote e te lire.

Ai u perpilua ne tre kopje me fuqi te barabarta secila, per t'u depozituar ne QKB, per t'u shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Tirane me 25.12.2024

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE **"ZYFI FARM" SHPK**

ZYFI GROUP
Marild ZYFI

Gerald ZYFI

Jetlira BEQIRAJ

Arjona ZYFI

Marild Zyl


Gerald Zyl


Jetlira Beqiraj


Arjona Zyl
